REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 12 prot

Tepelenë, më 29.10.2026

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot më **29.10.2026**, në orën **11:00**, në **Pallatit të Kulturës, Tepelenë (kati i dytë)**, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Në momentin e hapjes së mbledhjes ishin të pranishëm këshilltarët: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.**

Përfaqësues të administratës së Bashkisë Tepelenë: **znj.Julinda Karteri, z.Armand Sala, znj.Besiana Xhafa, znj.Rovena Mullara.**

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni; Përshendetje, fillojmë mbledhjen e radhës te muajit Tetor me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes datë 30.09.2026.
3. **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shtator 2026."
4. **Projektvendim**: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Shtator 2026."
5. **Projektvendim**: "Për miratimin e listës së poseduesve jopronar për paketën e maleve."
6. **Projektvendim**: "Për miratimin e planit vendor të parandalimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Tepelenë."
7. Raportim për problematikat dhe veprimtarinë në Njësitë Administrative (Qytet, Qëndër, Lopës, Kurvelesh) të Bashkisë Tepelenë.
8. Çështje të tjera.

9. Trajtimi i ankesë, kërkesave të qytetarëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak z.Arben Gumeni: Përshendetje fillojmë mbledhjen e muaji Tetor, pika e parë e rendit të ditës, jeni dakort me rendin e e ditës ta hedhim në votim.

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka

Pikën e pestë të rendit të ditës nuk u kalua në komision për arsye të verifikimit dhe marrjes së informacionit për këto parcela sic ju e dini ne duam mos të ketë konflikte, dhe probleme në ato zona. po ka probleme do zhvillojmë dëgjesa publike.Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës.

Pika e dytë e rendit të ditës; Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së radhës datë 30.09.2026. Jeni dakort, ta hedhim në votim.

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka

Projektvendim: "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shtator 2026."

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat:

Komisioni u mblodh dje diskutoi ketë pvendim, nuk ka ndryshime nga muaji i kaluar janë 10 familje që trajtohen me një fond 46.531 lekë, ftoj anëtarët e këshillit ta votojnë këte p/vendim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Ka pyetje për këtë pikë? Ta hedhim ne votim.

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Arben Gumeni: Projektvendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Shtator 2026."

Fjalën e mori znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat: Për këtë pikë për muajin Shtator kemi shtesë 4 familje 3 familje Njësia administrative Qytet, 1 familje njësia administrative Qëndër, listën e keni përpara. Ju ftojë ta votojmë këtë projektvendim pasi janë famije në nevojë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Arben Gumeni: : Ka pyetje për këtë pikë? Ta hedhim në votim. Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.** Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Arben Gumeni: Projektvendim: "Për miratimin e planit vendor të parandalimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Tepelenë."

Znj.Julinda Karteri; Përshëndetje, plani vendor të parandalimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve, ky dokument është i rëndësishëm ne jemi krenar për paraqitjen e këtij plani i përpiluar nga grupi i punës i Bashkisë Tepelenë me mbështejen nga FLAG në kuadër të projektit Bashki të forta për periudhën 2026-2031. Bashkia Tepelenë në vitin 2025 ishte një në 13 bashkitë që fitoi nga fondi i performancës një fond të caktuar me të cilin ne vendosëm të punojmë për këtë projektvendim, një punë gjatë vitit 2025 me grup pune të Bashkise Tepelenë. Bashkia Tepelenë është mirënjohës ndaj FLAG dhe stafit të të ngarkuar me hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, për angazhimin, përkushtimin dhe bashkëpunimin e treguar gjatë gjithë procesit gjithëpërfshirës të përgatitjes. Kontributi profesional, njohja e nevojave të territorit dhe komunitetit dhe përfshirja aktive në identifikimin e prioriteteve kanë qenë elementë thelbësorë për ecurinë e procesit të hartimit. Nëpërmjet këtij Plani, Bashkia Tepelenë synon të përmbushë parimet e ekonomisë qarkulluese duke i trajtuar mbetjet si pjesë e burimeve të shterueshme për komunitetin dhe brezat që vijnë. Plani vendos parandalimin e gjenerimit të mbetjeve në qendër të procesit planifikues, në përmbushje të detyrimeve të planit kombëtar të parandalimit. Në vijim parashikon përpjekje të shtuara për proceset e rikuperimit të materialit përmes riciklimit, duke u mbështetur në përvojën pararojë të menaxhimit rajonal të mbetjeve me standard europian.

Nga ana jonë dhe me këshillin janë bërë konsultime publike në të gjitha njësitë administrative për këtë plan ndaj ne sot kemi kaluar të gjitha fazat dhe po e paraqesim sot këtë dokument për miratim. Ky plan ka një rendësi në procesin kombëtar sepse Aspirata e Shqipërisë për t'u integruar në Bashkimin Europian, e konkretizuar përmes Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duhet të mbështetet nga një zhvillim i qëndrueshëm mjedisor. Për këtë qëllim janë përcaktuar një sërë objektivash, përmbushja e të cilëve monitorohet dhe vlerësohet çdo vit në raportet vjetore të BE-së për Shqipërinë, përkatësisht në Kapitullin 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike.Konteksi i dytë është korniza ligjore dhe e politikave Në bazë të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, nenit nr. 108, "Mjedisi", Shqipëria është angazhuar të zhvillojë dhe të forcojë bashkëpunimin me BE në luftën kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

Pozicioni negociues i Shqipërisë i shpalosur në Nëntor 2025, është i orientuar drejt përmbylljes së negociatave të pranimit deri në vitin 2027 dhe arritjen e anëtarësimit deri në vitin 2030. Shqipëria ka hapur të gjashtë grup-kapitujt negociues, me të fundit mbi burimet, bujqësinë dhe kohezionin. Në këtë proces Kapitulli 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, ku përfshihen objektivat në fushën e ekonomisë qarkulluese dhe menaxhimit të mbetjeve, është ndër kapitujt më kompleks të negociatave. Hapi i radhës, vendimtar, është përmbushja e standardeve të ndërmjetme dhe mbyllja e kapitujve, të cilat do të kërkojnë zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të legjislacionit të BE-së. Ky hap përfshin dhe udhërrëfyesit e zbatimit të politikës specifike të BE-së për menaxhimin e mbetjeve, sipas afateve kohore të dakordësuara mes BE-së dhe Shqipërisë. Ministria përgjegjëse për mjedisin, për të drejtuar politikën shtetërore në fushën e menaxhimit të mbetjeve, harton Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe planin e veprimit, si dhe Planin Kombëtar Sektorial të Menaxhimit të Mbetjeve.

Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035 është hartuar nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim nr. 418 datë 27.05.2020. Objektivat specifike të strategjisë janë të ofrojë zgjidhje praktike në:

- trajtimin e problemeve të deritanishme të sistemit të menaxhimit;
- zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi;
- përmbushjen e detyrimeve specifike të legjislacionit të KE për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë objektivat ambiciozë të paketës për ekonominë qarkulluese.

Pesë qëllimet strategjike përqendrohen në:

Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit;

Përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve;

Financimin e qendrueshëm të menaxhimit të mbetjeve; Burimet njerëzore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjen e popullatës në menaxhimin e mbetjeve; Instrumentat ligjorë, institucionalë dhe financiarë për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Për objektivat që ka ky plan do na flase ing Besjana;

Znj. Besjana; Objektivat strategjikë janë pesë:

1. Parandalimi i krijimit të mbetjeve

2. Zhvillimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve bashkiake, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe me pjesëmarrjen aktive të komunitetit, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

3. Forcimi i kapaciteteve institucionale, administrative dhe teknike të Bashkisë Tepelenë për menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve dhe zhvillimi i kuadrit rregullator në përputhje me legjislacionin.

4. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve përmes ofrimit eficient të shërbimit, duke garantuar mbulimin e kostove dhe përballueshmërinë e tarifës.

5. Forcimi i kulturës së reduktimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe bizneseve, mbetjeve përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe biznesit.

Për cdo objektiv janë vendosur disa matësa dhe gjatë periushës së këtij plani deri ne vitin 2031, pjese e rëndësishme monitorimi dhe vlerësimi. Ky plan i Bashkisë Tepelenë synon përmirësimin e shërbimëvë te qytetarëvë në qytet dhe në fshat.

Z. Ditar Hodaj; Grupi i punës Administratori i njësisë Lopës nuk ka firmosur, ka pasur arsye, ka qënë kundër, ska informacion?

Znj.Julinda Karteri; Nuk ka arsye me shkrim.

Z. Vladimir Bakiaj; Sa është afati i këtij plani?

Znj.Julinda Karteri; Ky plan 5 vjecar 2026-2031, ky është akt për rritjen e cilësisë se qytetarëvë. Plani që është sot për miratim është në bashkëpunim të politikave shqiptare në lidhje

me mjedisin dhe grumbullimin e mbetjeve, bashkia jonë duke qënë se është pjesë e parkut kombëtar të Vjosës ne jemi nga ato bashki që jemi të mbështetura ne projekte si për mbetjet ashtu dhe për tjërat e ndotura që derdhen në Vjosë. Ne jemi pjesë e projktit të Bankës Botërore një projekt që po përfundon, sidomos për stacionin fushe e mbetjeve, është një shqetësim për të gjithë. Ne para dy muajsh miratuam vendimin për dhenien e dakortësisë per realizimin e ndërhyrjes se rehabilitimit të vendepozitimit te mbetjeve, keto do kalojnë në këshill bashkiak pastaj finalja ngritja e sistemit të trasferimit për mbetjet, do të ketë akte të tjera sepse kjo do të jetë në bashkëpunim, ne do vime përsëri në Këshill për këtë proces.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Arben Gumeni: Ka pyetje për këtë pikë? Ta hedhim në votim.

Vota Pro 12: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.**Vota kundër: S'ka,Vota abstenim: S'ka

Pika e shtatë e rendit të ditës; Raportim për problematikat dhe veprimtarinë në Njësitë Administrative (Qytet, Qëndër, Lopës, Kurvelesh) të Bashkisë Tepelenë. Administratori i Njësisë Administrative Lopës ka përcjellë një shkresë zyrtare, nëpërmjet së cilës njofton se, për arsye shëndetësore, nuk mund të jetë i pranishëm në mbledhje. Gjithashtu administratori i Njësisë Administrative Kurvelesh ka njoftuar se, për shkak të një angazhimi emergjent pune, nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, në mbledhjen e radhës të paraqiten administratorët e Njësive Administrative Qytet Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh, për të raportuar mbi problematikat dhe punën e kryer në njësitë përkatëse.

Z.Leonidha Shumeli: Relaton materialin e paraqitur dhe të bashkëlidhur.

Z. Ditar Hodaj; Duke qenë se ka pasur rritje të investimeve në infrastrukturë, a është shoqëruar kjo me rritje apo ulje të numrit të popullsisë në zonë?

Z.Leonidha Shumeli: Pavarësisht se numri i banorëve ka pësuar rënie, në disa zona, si në Dukaj dhe Bënçë, vihet re një fluks në rritje i turistëve. Ka lëvizje migratore të popullsisë, por kjo nuk përbën pengesë për zhvillimin e zonës, e cila ka potencial për zhvillimin e turizmit.

Z. Vladimir Bakiaj: Infrastrukturës rrugore në lagjen e poshtme të fshatit Dukaj. Konkretisht, pavarësisht ndërhyrjeve në aksin rrugor Fushë Dukaj–Memaliaj, në rrugët e brendshme të kësaj lagjeje nuk është ndërhyrë dhe infrastruktura vijon të jetë në gjendje të amortizuar, duke lënë për të dëshiruar.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Arben Gumeni: Për këtë ndërhyrje është hartuar projekti dhe është dërguar pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit për financim, pasi Bashkia nuk ka mundësi financiare për ta realizuar këtë investim me fondet e saj.

Z.Leonidha; Ne në shërbim të komunitëtit tek ai aks po punohet mjetet aty janë po punojnë.
Z.Dino Selim; Të falenderoj për punën e bërë, ajo rrugë është futur tek fondi i zhvillimit.

Znj.Julinda Karteri; Bashkia e mirëmban atë segment dhe gjithë të tjetët ne jemi aty për cdo problem per qytetarët. Janë projekte që ne nuk i arrijmë dot ne sot këtu për të thënë qe kemi aplikuar te Fondi i Zhvillimit .

Z.Vladimr Bakiaj; Të shtrohen rrugët e tjera.

Znj Milela Varfi; Të falenderoj për raportimin, për problemin e rrugës skrepi ka tre ditë që po punon në ate segmnt. Punëtoret tek rruga më korekt në punë. Ujësjëllësi jemi pa ujë prej 8 muajsh.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Arben Gumeni: Tek çështje të tjera, kemi një material të ardhur nga aparati i Bashkisë, për të cilin do të na informojë znj. Julinda Karteri.

Znj.Julinda Karteri: Kërkohet mendimi nga ne, materiali erdhi dje në Bashki dhe është përgatitur propozimi së bashku me relacionin shpjegues, projektvendimin dhe referencat ligjore. Këshilli Bashkiak, me vendimin nr. 62, datë 31.10.2024, ka miratuar në parim kontratën e qirasë me tarifë simbolike 1 euro për shoqërinë "Zagroturizëm". Në vijim të propozimit të paraqitur nga Bashkia, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Shtetërore, na ka bërë me dije se praktika e këtij projektvendimi duhet të plotësohet edhe me një vendimmarrje të Këshillit Bashkiak për miratimin e kalimit të kontratës së qirasë nr. 997 rep, nr. 554 kol., datë 16.09.2024, në kontratë qiraje me tarifë simbolike 1 euro. Kjo kërkesë bëhet në

përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 6, datë 01.09.2026, për zbatimin e VKM-së nr. 54/2014, të ndryshuar.

Z.Vladimir Bakiaj; Ne e kemi kaluar në këshill, dhe Vendimin e këshillit bashkiak që kemi miratuar ta verifkojme

Znj.Julinda Karteri: Vendimi i këshillit bashkiak nr,62 datë 31.10.2024, ne jemi në procedure të udhëzimit nr 6 datë 01.09.2026 .

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Arben Gumeni: Ka pyetje për këtë pikë? Ta hedhim në votim.

Vota Pro 11: **Arben Gumeni, Dino Selimi, Mirela Varfi, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Besnik Maça, Matilda Çela, Ditar Hodaj, Mjaftoni Zeraj, Marsela Balili.**Vota kundër: 1 vote,Vota abstenim: S'ka

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Arben Gumeni: Ka ardhur një shkresë nga Kuvendi i Shqipërisë, e përcjellë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, nëpërmjet së cilës kërkohet dhënia e mendimit lidhur me projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Në përgjigje të kësaj shkrese, do të përcillet qëndrimi i Këshillit Bashkiak Tepelenë, i njëjtë me atë të miratuar më parë nga Këshilli Bashkiak nëpërmjet vendimmarrjes përkatëse, pas zhvillimit të procesit të konsultimit publik. Ky është i njëjti qëndrim që i është përcjellë edhe Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Znj.Julinda Karteri: Këshilli Bashkiak Tepelenë ka të njëjtin qëndrim me atë të shprehur në vendimmarrjen e dalë nga procesi i konsultimit publik dhe të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Z. Ditar Hodaj; Kërkoj të njihem me materialin e plotë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Vazhdojmë për shqyrtim kërkes-ankesa te qytetrëve si më poshtë:

1. Kërkesë e banorëve të lagjes "Demokracia", të cilët kërkojnë ndërhyrjen e Bashkisë për sistemimin dhe rikonstruksionin e rrugës që shërben për banorët e kësaj lagjeje, pasi ajo është e amortizuar dhe nuk ka ndriçim publik. Kërkesa t'i përcillet Bashkisë Tepelenë, drejtorisë përkatëse, për shqyrtim dhe ndjekje.(bashkelidhur kerkesa)

2. Kërkesë e z. Ermal Çuna, banor i qytetit Tepelenë, i cili kërkon ndihmë financiare për arsye shendetsore .Kërkesa t'i përcillet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim dhe vlerësim, në përputhje me kriteret dhe mundësitë ligjore.(bashkelidhur kerkesa)

3. Kërkesë e z. Mustafa Koka, banues në Tiranë, i cili kërkon blerjen e sipërfaqes së truallit mbi të cilën janë ndërtuar shkallët e marketit, pronë e tij, me qëllim bashkimin e kësaj sipërfaqeje me pronën ekzistuese dhe regjistrimin e tyre si një pasuri e vetme. Kërkesa t'i përcillet Bashkisë Tepelenë, drejtorisë përkatëse, për shqyrtim dhe verifikim të dokumentacionit pronësor. .(bashkelidhur kerkesa)

4. Kërkesë e znj. Arta Seferi, banore e qytetit të Tepelenës, e cila kërkon ndërhyrjen e Bashkisë për zgjidhjen e disa problematikave në banesën e saj, që lidhen me praninë e lagështirës, problemet me rrjetin e ujërave të zeza, si dhe ndërtimin e një muri rrethues për oborrin e banesës. Kërkesa t'i përcillet Bashkisë Tepelenë dhe drejtorive përkatëse për shqyrtim dhe vlerësim të mundësive për ndërhyrje. (bashkëlidhur kerkesa)

Kryetari i Këshillit Bashkiak: Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, deklaroj të mbyllur mbledhjen. Ju faleminderit!

Mbyllet mbledhja e Këshillit Bashkiak në orën 12:06.

SEKRETARE E KËSHILLIT
Valbona ÇELA

KRYETARI KËSHILLIT
Arben GUMENI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCA E KËSHILLTARËVE
MBLEDHJA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË
Datë: 29.10.2026

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 29.10.2026 morën pjesë këshilltarët si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Nënëshkrimi
1	ARBEN GUMENI	
2	MATILDA ÇELA	
3	DINO DELIMI	
4	MIRELA VARFI	
5	MJAFTONI ZERAJ	
6	ESMERALDA BISHANI	
	BESNIK MAÇA	
8	LATIF KAÇAJ	
9	MIFTAR META	
10	ILIR HASKA	
11	MARSELA BALILI	
12	MARIOS JORGO	
13	DITAR HODAJ	
14	VLADIMIR BAKIAJ	
15	VLADIMIR GJONÇA	